



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 4, datë 18.01.2024

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË GJYQTARES {...} PËR SHKAK TË SUPRIMIT TË POZICIONIT NË GJYKATËN KU ËSHTË CAKTUAR NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 42 dhe 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares znj. {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ku është caktuar në mënyrë të përhershme.
2. T’i kërkojë gjyqtares znj. {...}, të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes për tu transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm, si më poshtë:
 - i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës civile;
 - ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës civile;
 - iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës penale.
3. E drejta e zgjedhjes sipas pikës 1 duhet të ushtrohet brenda 3 (tre) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.
4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR